



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 04.09.2025  
Numër Protokolli: 6022/2025

A.nr.1451/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1451/2025, të datës 23.07.2025, të parashtruar nga ankuesja Sh.K kundër organit të punësimit: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në çështjen juridike “*transferim si pasojë e ristrukturimit*”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.09.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet si bazuar** ankesa me numër A.nr.1451/2025, e datës 23.07.2025, e parashtruar nga ankuesja Sh.K.
- II. Anulohet** Vendimi me Nr.R.AShAK:26/2025 i datës 20.06.2025 i protokolluar më datë 23.06.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Pika II me numër Rendor 11 e Raportit të Komisionit të Ristrukturimit të datës 11.06.2025 të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës lidhur me rastin e propozimit për transferimin e ankuses, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij, duke e bërë rishqyrtimin e rastit të ankuses në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile Sh.K (*referuar tutje vetëm ankuesja*), më datë 23.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.R.AShAK:26/2025 të datës 20.06.2025 të protokolluar më datë 23.06.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.07.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 21.08.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4982/2025 të datës 23.07.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. R.AShAK:26/2025 të datës 20.06.2025 të Drejtorit të DMZP-së; Vendimin me Nr. 145/2022 të datës 10.11.2022 të zv. Drejtores se DMZP-së; Emailin e datës 23.07.2025 nga ankuesja për Q.K; Emailin e datës 22.04.2025 nga ankuesja për Q.B; Akt Emërimit të datës 07.10.2022; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 21.08.2025; Vendimin e datës 07.03.2025 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në ASHAK; Raportin Përfundimtar të datës 10.06.2025 të Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin e datës 22.04.2025 për shtyrjen e afatit për përfundimin e raportit të ristrukturimit; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës i Arkivit Ndërkomunal Prishtinë datë 19.09.2024; Diplomën e ankueses Nr. 20/389; Vendimin e datës 29.12.2014 të MASHT; Vërtetimin E DATËS 14.11.2006; Kërkesën për verifikim të dokumentacioneve e datës 02.09.2013; Certifikatën e datës 10.03.2015 e përfundimit të studimeve Master; Diplomën me Nr. 12/15; Librezë e Studentit e datës 20.05.1995; Përshkrimin e punës së pozitën Drejtor i Departamentit të Arkivit Qendror datës 10.06.2025; Përshkrimin e punës së pozitën Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa i datës 10.06.2025; Përshkrimin e pozitës së punës Drejtor i Departamentit për Arkiva Digjitale datë 10.06.2025; Përshkrimin e pozitës së punës Drejtor i Departamentit për Planifikim, Standardizim, Hulumtim dhe Promovim datë 10.06.2025; Përshkrimin e pozitës së punës Drejtor i Departamentit për Shërbime të Menaxhimit të Përgjithshëm datë 10.06.2025; Përshkrimin e pozitës së punës Drejtor i Departamentit të Inspektimit i datës 10.06.2025; Përshkrimin e pozitës së punës Drejtor i Departamentit për Koordinimin dhe Mbikëqyrjen e Arkivave Ndërkomunal datë 10.06.2025; Listën e pagave për ankuesen maj dhe qershor 2025; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin datë 03.06.2025 dhe 28.02.2024; Emailin e datës 07.05.2025 nga B.R për S.K; Emailin e datës 23.10.2023 nga B.R për Sh.A; Vendimin me Nr. 141/2022 i datës 15.09.2022 i zv. Drejtores se DMZP-së; Emailin e datës 25.08.2025 nga A.B për B.R për prova dhe informata shtesë; Përgjigjen e datës 04.0-9.2025 nga B.R për A.B; Vendimin me Nr. 184/2023 të datës 13.11.2023 të Ministrit të MKRS-së; Vendimin me Nr. 102/2025 të datës 28.07.2025 të Ministrit të MKRS-së; Vendimin me Nr. 27/2025 të datës 26.02.2025 të Drejtorit Ekzekutiv të ASHAK; Kërkesën për emërimin e Komisionit të ristrukturimit në ASHAK e datës 20.08.2024.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja sipas Vendimit me Nr. 141/2022 të datës 15.09.2022 të zv. Drejtores së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, nga pozita Drejtor i Departamentit për Hulumtime dhe Përkrahjen e Investimeve në Diasporë në Ministrinë e Diasporës është transferuar në pitrën Drejtor i Arkivit Ndërkomunal në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, e ku si rezultat i kësaj më datë 07.10.2022 i është lëshuar Akt Emërimi për këtë pozitë. Duke qenë se më Vendimin A.nr.723/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është shfuqizuar Vendimi me Nr. 141/2022 i datës 15.09.2022, atëherë pas rishqyrtimit të rastit zv. Drejtorja e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë

10.11.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr. 145/2022 me të cilin ka konfirmuar transferimin e ankueses në pozitën Drejtor i Arkivit Ndërkomunal.

Tutje sipas Vendimit me Nr.128/2024 të datës 19.07.2024, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me ç'rast procesi i organizmit të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, është pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 07.03.2025, ka marr Vendimin me numër protokolli 221, për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ndërsa ky i fundit, më datë 11.06.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ashtu që ankuesen nga pozita Drejtore e Arkivit Ndërkomunal të Prishtinës e ka propozuar të transferohet në pozitën Udhëheqës i Arkivit Ndërkomunal në Prishtinë në kategorisë e ulët drejtuese. Në zbatim të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 20.06.2025 ka nxjerr Vendimin Nr.R.AShAK: 26/2025 të protokolluar më datë 23.06.2025, me të cilin ankuesen e ka transferuar nga pozita Drejtore e Arkivit Ndërkomunal të Prishtinës në pozitën Udhëheqëse e Arkivit Ndërkomunal në Prishtinës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr.R.AShAK:26/2025 të datës 20.06.2025 të protokolluar më datë 23.06.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se është transferuar në kategori më të ulët sesa kategoria që ka mbajtur. Kërkon që ankesa të vendoset në favorin e saj.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës së transferimit të nëpunësve civil në rast të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, respektivisht mori për bazë nenin 66 i cili përcakton se: *"1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësueset e institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës. 7. Qeveria, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedura të hollësishme për zbatimin e këtij neni. 8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës*

*së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve”.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit ju referuar Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, konkretisht nenit 12 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, ku përcaktohet: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimit i institucionit përcaktohet në legjislacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 4. Transferimi bëhet sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. Nëse nuk ka pozita të lira të së njëjtës kategori apo nëpunësi nuk plotëson kërkesat e pozitës së punës në të njëjtin institucion sipas nënparagrafit 3.1. të këtij neni, transferimi i tij mund të bëhet në institucionin tjetër sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3”.*

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë provat materiale të lëndës, fillimisht sa për konstatim të gjendjes faktike, thekson faktin se pakontestueshëm që ankuesja ka qenë e punësuar në kuadër të Ministrisë së Diasporës në pozitën Drejtor i Departamentit për Hulumtime dhe Përkrahjen e Investimeve në Diasporë, mirëpo pas ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Komisioni i Ristrukturimit në këtë ministri kishte konstatuar se ankuesja nuk plotëson kërkesat për sistemim në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke propozuar të transferohet në një institucione tjetër, dhe si pasoj e kësaj e njëjta është transferuar sipas vendimeve të cekura më lartë në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës në pozitën Drejtor e Arkivit Ndërkomunal në Prishtinë, e që sipas normave ligjore në fuqi respektivisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm në atë kohë) është transferuar në kategori të njëjtë pra në kategori të mesme drejtuese. Ankuesja kishte kontestuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimin për transferim në kuadër të këtij institucioni gjegjësisht Vendimin me Nr. 145/2022 të datës 10.11.2022 të zv. Drejtores së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, mirëpo Këshilli i pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit A.nr.1124/2022, kishte refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi vendimin e kontestuar dhe duke konstatuar se transferimi i ankueses në kategori të njëjtë nuk cenon të drejtat nga marrëdhënia e saj e punës.

Sipas Rregullores (ZKM) Nr.16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, pozitat e Drejtorëve të Arkivit Ndërkomunal janë kategorizuar në Udhëheqës të Arkivit Ndërkomunal në kuadër të kategorisë së ulët drejtuese, gjë që ka ndodhur edhe me rastin e ankueses, e për rrjedhojë sipas kësaj rregulloreje respektivisht sipas nenit 7 janë paraparë këto departamente: *Departamenti i Arkivit Qendror, Departamenti për Koordinimin dhe Mbikëqyrjen e Arkivave Ndërkomunale, Departamenti për Planifikim, Standardizim, Hulumtim dhe Promovim, Departamenti i Inspektimit të Fondkrijuesve dhe Foandposeduesve, Departamenti i Arkivave Digjitale, Departamenti për Buxhet dhe Financa, dhe Departamenti për Shërbime të Menaxhimit të Përgjithshëm.* Nëse referohemi Raportit Përfundimtar me numër protokolli 1196 të datës 11.06.2025 të Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, rezulton se nga shtatë (7) departamentet sa janë paraparë sipas Rregullores (ZKM) Nr.16/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, janë sistemuar vetëm katër nëpunës në pozita të kategorisë së njëjtë pra sistemimi i nëpunësve është bërë në pozitën Drejtor i Departamentit për Planifikim, Standardizim, Hulumtim dhe Promovim, Drejtori i Departamentit të Arkivit Qendror; Drejtor i Departamentit për Koordinim dhe Mbikëqyrjen e Arkivave

Ndërkomunale dhe Drejtor i Departamentit për Shërbime të Menaxhimit të Përgjithshëm, e për rrjedhojë edhe tri departamente kanë mbetur pa u trajtuar nga Komisionit të Ristrukturimit, respektivisht të njëjtat konsiderohen të pa plotësuar, edhe pse më datë 25.08.2025, kemi kërkuar informacione nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës se sa pozita të kategorisë së mesëm drejtuese janë të lira brenda institucionit, ndërsa më datë 04.09.2025 kemi pranuar informatën përmes emailit se pozita të lira të kategorisë së mesme drejtues janë *Departamenti të Arkivave Digjitale, Departamenti i Inspektimit të Fondkrijuesve dhe Foandposeduesve dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa.*

Kolegji i Këshillit, i referuar gjendjes se fakteve, konstaton se sipas Vendimit me Nr. 145/2022 të datës 10.11.2022 me të cilin ankuesja është transferuar në pozitën Drejtor i Arkivit Ndërkomunal e njëjta është transferuar në pozitë për nga kategoria në atë të mesme drejtuese sikurse që e ka mbajtur në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në të kundërtën nëse nuk do të ishte ky transferim në kategori të mesme drejtuese Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës do ta anulonte të njëjtin ngase nuk do të ishte ligjore të transferohej në një kategori tjetër kur dispozitat e aplikueshme në atë kohë respektivisht neni 54 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përcaktonin se transferimi bëhet në kategori të njëjtë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me rastin e propozimit për transferimin e ankueses nga pozita Drejtore e Arkivit Ndërkomunal të Prishtinës në pozitën Udhëheqëse e Arkivit Ndërkomunal në Prishtinë e ku të dyja këto pozita i ka konsideruar si pozita të kategorisë së ulët drejtuese, nuk kishte parasysh faktet dhe rrethanat se ankuesja ishte transferuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës në kategori të mesme drejtuese, dhe si rezultat i kësaj, Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave sipas provave të lëndës, nuk ka ndërmarr apo nuk ka bërë përpjekje që fillimisht të konstatohet ky fakt, e pastaj ankuesja të propozohet të transferohet në një pozitë të kategorisë së mesë drejtueses edhe për kundër faktit që ka pasur mundësi të tilla, mirëpo ka propozuar sistemimin e ankueses në pozitë të kategorisë së ulët drejtues duke dalur përtej Vendimit me Nr. 145/2022 të datës 10.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se me rastin e propozimit për transferim të ankueses në kategori të ulët drejtues nga ana e Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, të njëjës i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e saj e punës respektivisht nga e drejta e fituar sepse e njëjta pozitë e kategorisë së mesë drejtues e ka fituar dhe mbi bazë të këtyre rrethanave, por edhe normave ligjore të përcaktuara me nenin 66 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori”*, dhe nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, propozimi për transferim duhet të ishte në kategori të njëjtë pra të mesëm drejtuese, në rrethanat tjera propozimi për transferim është në kundërshtim të plotë me gjendjen e fakteve të prezantuara si më lartë dhe dispozitat ligjore në fuqi të elaboruara si më lartë.

Andaj, përkitazi me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr.R.AShAK: 26/2025, të datës 20.06.2025 të protokolluar më datë 23.06.2025, ë Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr në kundërshtim me nenin 66 paragrafi 1 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, andaj përkitazi me konstatimet e sipër cekura, Kolegji i Këshillit, sipas provave të lëndës, vendosi të aprovojë si të bazuar ankesën e ankueses, të anuloj vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe të anuloj Pikën II me numër Rendor 11 të Raportit të Komisionit të Ristrukturimit të datës 11.06.2025 të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës lidhur me rastin e

propozimit për transferimin e ankueses, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, me obligimin që Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës në procedurë të rishqyrtimit të shqyrtoj në mënyrë të drejtë procesin e sistemit të ankueses të marr parasysh dispozitat ligjore në fuqi gjegjësisht dispozitat e nenit 66 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

***Këshillë juridike:*** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1451/2025**

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses Sh.K;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB;
- Organit të punësimit: Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.